

Specifikime Teknike të uniformave zjarrduruese.

1-Helmeta zjarrduruese. Helmeta është në përdorim, për mbrojtjen kundër zjarrit dhe duhet të jetë sipas standartit ndërkombëtar EN 443:2008. Helmeta duhet të jetë e paisur me një xham transparent me ngjyrë luminishence, të punuara nga materiali PESU për të rezistuar ndaj temperaturave të larta. Ajo duhet të jetë e paisur me një amortizues të punuar nga poliuretani I integruar në gëzhhojën e helmetës. Në mes të gëzhhojës e cila duhet të jetë, me material fibra karboni. Për tu përshtatur me kokën, rregullimi I madhësisë, të bëhet përmes një rregullatori, me ndryshim madhësie nga 52-64. Përmasat gjerësia 236-247mm, gjatësia deri 316mm dhe lartësia deri 216mm. Të dyja anët e helmetës duhet të paisen me një shirit reflektues. Gjerësia e shiritit të jetë 24-25mm. Duhet të jetë me një mbrojtëse për qafën e përbërë me fibra karbonikë dhe trajtuar me alumin. Peshë totale të jetë 1.4kg. Në pjesën ballore të saj të jetë vendi për logo. Helmeta duhet të jetë rezistente në temperaturë deri 1000 gradë për 10 sekonda si dhe i testuar në temperaturë 350 gradë për 30 minuta. Rripi I mjekrës të jetë material prej nomex. Të jetë e paisur me llampë ndricuese Xenon.

2- Xhaketa zjarrduruese. Xhaketa duhet të jetë e certifikuar, në përputhje me standartin EN 469-2020 niveli 2 i mbrojtjes. Subjekti duhet të paraqesë certifikatën e vlevshme të produktit. Në xhakëtë mbrapa në pjesën e sipërme, të vendoset një shirit me përmasa në lartësi 15 cm dhe gjerësi sa ajo e gravurave, me ngjyrë gri metalizato, mbi të cilën shkruhet me shkronja shtypi kapitale "MZSH" dhe shrimi të jetë me ngjyrë blu e errët, me përmasa 10-1.8cm. Në pjesën e përparme të xhakëtës, vendoset një xhep, rreth 2cm majtas, nga shiriti I përparmë.

Pjesa e pasme duhet të jetë e ndarë në dy seksione horizontalisht. Mbishkrimet në shpinë duhet të jenë, në një ose dy rreshta dhe madhësia e shkronjave të jetë 6cm dhe ngjyra e sfondit të jetë e verdhë flourishente, kurse e shkronjave e argjendë. Në shirit të shkruhet "MZSH" dhe ngjitja të behet me velkro ose e përhershme. Xhepat anësorë të jenë të future Brenda e të mbuluar me kapak, me dimesion 22x7.5cm dhe kapakët në pjesën e poshtme të mbyllen me shirit velkro. Xhaketa të jetë me astar të përhershëm rezistues ndaj zjarrit. Astar i nuk duhet të jetë ifiksuar në asnjë pikë me tegelat e qepjes.

Përshkrimi I detajuar në skicë: Duhet të jetë rezistente ndaj temperaturave të larta, penjtë te jenë, material kunder lagështires dhe rezistentë ndaj zjarrit, zinxhoret të jenë rezistent ndaj zjarrit dhe të mbuluar me kapak si dhe xhepa anësorë më kapak. Përbëria e materialit të shtresës së jashtme të jenë, përzierie e fijeve aramidi dhe fijeve karboni, me ngjyrë blu e errët. Materiali për saldimin e qepjeve, duhet të jetë membranë mikroporoze dy komponentëshe. Astar i Nomex FR50%. Jastëkët mbrojtës mbi supe, shërbejnë si amortizues dhe të jenë material I qëndrueshëm nga flakët, nga plastike jo absorbuese që nuk thithin lagështi. Këto të jenë të testuar sipas standartit EN532 dhe të jenë pa shkrirje e ndezje. Zinxhiri duhet të jetë I paisur me patent paniku e dhëmbë metalik me madhësi 8mm. Shiritat velkro duhet të jenë rezistent ndaj zjarrit e në larje. Penjtë të jenë rezistent ndaj flakës, 100% nda material aramid dhe me ngjyrë blu të errët. Shiritat reflektues të jenë me ngjyrë të verdhë në të argjendë.

Jaka (në pjesën e brendëshme) dhe bërrylat të jene me përforcues. Përforcuesi i bërrylave të jetë në formë drejtkëndëshi në përmasa 20 x 30 cm. Jaka (në pjesën e brendëshme) të ketë përforcim me tegela me distancë 8mm larg njëri-tjetrit, hapi i tegelit të jetë rreth 2-4 mm.

Të ketë xhep tek kraharori për radion me gjerësi 12 cm me thellësi 16 cm, me kapak mbrojtës 7 cm si dhe 2 xhepa anësor me kapak 7 cm me gjerësi 20 cm, thellësi 25 cm.

Kapakët e xhepave të fiksohen tek xhaketa me material VELKROF.

Mëngët të jenë të qepura mansheta me gjerësi 12cm dhe të jenë të papërshkueshme nga uji. Mansheta e brendshme nga material I thurur dy shtresor me hapje të rrumbullakët. Materiali të jetë me përbërje 93% meta aramid, 5% para ramid dhe 2% fibra karboni dhe me ngjyrë blu e errët.

3-Pantallona me shtrat të gjatë. Pantallonat duhet të jenë të certifikuara sipas standartit En 469:2020. Pantallona, pjesë e uniformës personale mbrojtëse ndaj zjarrit, të jetë e tipit me prerje të lartë shtarti. Penjtë të jenë prej metali kundër lagështisë dhe rezistencë ndaj zjarrit, Qemeri të jetë i përshkruar nga brenda me llastik, i përshatshëm të qëndroj mirë ne bel, te dyja anet duhet te jene te pajisura me shirita elastike, 4 cm te gjere. Të vendoset nga një shirit reflektimi (fluoreshent), që ti rezistojë nxehtësisë së zjarrit me cilësi si copa e xhaketës, gjerësia e shiritit do të jetë 6 cm, me largësinë 25 cm nga fundi i pantallonat në gjithë parametrin e tij. Sa më sipër specifikuar dhe detajuar në skicë. Pjesa e gjurit të jetë e përforcuar me shtresë (nga jashtë) të të njëtit material si i pantallonave me gjatësi 25 cm dhe gjerësi 20cm. Shirit florishent do ti mbivendoset copës së jashtme te pantallonat me gjerësi rreth 7,5 cm Penjtë të jenë material kundër lagështirës dhe rezistencës ndaj zjarrit. Zinxhirët të tipit të qëndrueshëm dhe rezistent ndaj zjarrit dhe i mbuluar me kapak. Cilësia e zinxhirëve të pantallonave, e penjëve për qepje dhe aksesoreve të jashtëm, që i ekspozohen veprimit të nxehtësisë dhe ujit , duhet të përmbushin kërkesat e standardit të copës së jashtme.

4-Doreza për mbrojtjen nga zjarri .Te përmbushë kerkesat e standartit , EN 659 :2008 Duhet të jenë absolutisht të papërshkueshme nga uji. Mbrojtje ekstreme nga konsumi në pjesën e brendshme, mbrojtje nga të nxehtë dhe të ftohtit. Mbrojtje shtesë të gishtave nga material kevlar të përforcuar me material shtesë. Të kenë izolim të dyfishtë në zonën e ekspozuar sidomos pjesën e pasme të dorës.

5-Cizmet mbrojtëse nga zjarri. Të përmbushë kerkesat sipas standartit : EN ISO 15090 : 2012 F2A HI3 P T CI AN SRC. Cizmet te jene nga material lekure e zeze, si dhe duhet te jene te pajisur me vege anash per veshje me te lehte dhe te shpejte. Te jene te pajisur me shirit reflektues. Cizmet te jene rezistente ndaj ujit, nxehtesise, vajrave, derivative dhe te jene antistatike. Në mes të astarit dhe lëkurës së jashtme të jenë të pajisur me një membranë të papërshkueshme ndaj ujit dhe rezistente në flakë.

